



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:239617
Datë: 07.03.2024
Numri i dokumentit: 05422027

C-IV.-14-6075

Ankuesi:

C K nga Prishtina
Përfaqësuar nga av.B I nga Prishtina.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Silloga K.H.T Kosova”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrije Shala, me dt.05 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN124-1217 i dt.26 gusht 2014.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.08 shtator 2014, ankuesi ish punëtor i NSH “Silloga K.H.T Kosova” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr.PRN124-1217 i dt.26 gusht 2014, me të cilin ka kërkuar dëmshpërblim për të ardhurat personale gjatë viteve 1990-1999, si dhe pensionet e pretenduara si të porealizuara plotësisht, në shumë prej 16,273.34€. Ankuesi në ankesë ka deklaruar se AL me rastin e marrjes së vendimit nuk e ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale. Ankesës i ka bashkangjitur Transaksionet bankare, Pasqyrën e llogarisë së Trustit, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Vërtetim të lëshuar nga NSH “Kosova” nr.13 dt.22.03.2005, Njoftim për pensionistët e KHT “Kosova”, Kërkesa e AKP nr.5243 dt.03.06.2014, Vendimi nr.726 dt.21.12.1999, Vendimi PRN124-1217 dt.26.08.2014.

Me dt.18 gusht 2016 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit, pasi që AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht e që objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë për ta shfuqizuar. Kërkesa e ankuesit është e pa bazuar pasi që i njëjti nuk ka ofruar punë gjatë viteve 1990-1999. Ashtu që ka kërkuar që kërkesëpapia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata ka tentuar që ankuesit personalisht të ia dorëzoj një kopje të mbrojtjes së paraqitur nga pala e paditur, mirëpo kjo nuk ka mundur që të realizohet nga shërbimi postar. Kështu, me dt.23 maj 2022, i autorizuari i ankuesit e ka dorëzuar në gjykatë një parashtrësë me anë të së cilës ka kërkuar përshpejtimin e procedurës lidhur me këtë lëndë, si dhe ka bërë dorëzimin e autorizimit të palës për përfaqësim në këtë procedurë gjyqësore.

Gjykata me dt.26 korrik 2023, përmes një urdhri të lëshuar ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore, siç është kopja e librezës së punës, kopja e listës së pagave dhe prova tjera që dëshmojnë se NSH-ja i ka mbetur borxh ankuesit. I autorizuari i ankuesit e ka pranuar urdhrin me dt.31 korrik 2023, por deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën kohore 1990-1999. Ankuesi së bashku me ankesë ka dorëzuar Transaksionet bankare, Pasqyrën e llogarisë së Trustit, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Vërtetim të lëshuar nga NSH “Kosova” nr.13 dt.22.03.2005, Njoftim për pensionistët e KHT “Kosova”, Kërkesa e AKP nr.5243 dt.03.06.2014, Vendimi nr.726 dt.21.12.1999, Vendimi PRN124-1217 dt.26.08.2014. Këto prova nuk vërtetojnë se ankuesit i takon e drejta e pretenduar. Ankuesi ka dështuar që të dorëzojnë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të urdhrin të dt.26 korrik 2023, duke vendosur që të mos i përgjigjet të njëjtit.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë kopja e librezës së punës, kopja e listës së pagave dhe prova tjera që dëshmojnë se NSH-ja i ka mbetur borxh ankuesit për periudhën e kërkuar. Por i njëjti e ka pranuar urdhrin e lëshuar nga gjykata me dt.26 korrik 2023, dhe deri në kohën e përpilimit të vendimit nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Gjykata konstatoj se me vendimin nr.13 i dt.22.03.2005 i lëshuar nga KHT “Kosova”, dëshmohet se ankuesi ka ofruar shërbime për NSH-në nga dt.01.04.1978 deri me dt.30.12.2000, por se i njëjti nuk e vërteton fakti se NSH i ka mbetur borxh ankuesit ashtu siç pretendon i njëjti me ankesën e tij. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara për periudhën kohore 1990-1999 nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t’i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën me dt. 09 qershor 2022.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrije Shala